



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:282839
Datë: 08.03.2024
Numri i dokumentit: 05426411

AA.nr.687/2023

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS - Departamenti për Çështje Administrative, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Ramiz Kuqi kryetar, Delushe Halimi dhe Hajriz Hoti anëtarë, me bashkëpunëtoren profesionale Besarta Sopaj, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit, N.Sh, komuna e Glllogocit, kundër të paditurës, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Departamenti i Familjeve të Dëshmoreve, Invalidëve të Luftës dhe Viktimave Civile, me bazë juridike anulim i vendimit, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.2054/2019 të datës 13.03.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 06.03.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa e të paditurës Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Departamenti i Familjeve të Dëshmoreve, Invalidëve të Luftës dhe Viktimave Civile, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.2054/2019 i datës 13.03.2023, **vërtetohet**.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative A.nr.2054/2019 të datës 13.03.2023, në pikën I të dispozitivit është aprovuar në tërësi kërkesëpadia e paditësit N.Sh, si e bazuar. Në pikën II të dispozitivit është anuluar vendimi me numër Nr. Nr.01-01/8492 i datës 15.07.2018, i të paditurës Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Departamenti i Familjeve të Dëshmoreve, Invalidëve të Luftës dhe Viktimave Civile të luftës së UÇK-së dhe. Në pikën III të dispozitivit është vendosur që paditësit N.Sh ti njihet e drejta në Pension të skemës së invalidit të luftës së UÇK-së, nga data nga e parashtrimit të kërkesës 05.12.2018, dhe në të ardhmen derisa të ekzistojnë kushtet ligjore. Në pikën IV të dispozitivit është detyruar e paditura, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale-Departamenti i

familjeve të dëshmoreve dhe invalidëve të luftës, që paditësit N.Sh t'ia kompensoj pagesat në mënyrë retroaktive, në emër të pensionit për persona invalid të luftës së UÇK-së, nga data 05.12.2018 deri më 26.04.2023, në shumën totale prej 11,593.70 €, dhe kamatën në lartësi prej 8% gjithsej në shumën prej 13,607.94 euro në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit ligjor. Në pikën V të dispozitivit është detyruar e paditura, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale-Departamenti i familjeve të dëshmoreve dhe invalidëve të luftës, që paditësit, N.Sh që nga data 01.05.2023 dhe në të ardhmen derisa të ekzistojnë kushtet ligjore t'ia njoh dhe kompensoj shumën prej 225 euro për muaj, në emër të pensionit për invalid të luftës së UÇK-së. Në pikën VI të dispozitivit është vendosur që ky aktgjykim e zëvendëson aktin e anuluar dhe ka karakter detyrues. Në pikën VII të dispozitivit është vendosur që secila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ka ushtruar ankesë pala e paditur përmes përfaqësuesit të autorizuar, Ministria e Drejtësisë - Avokatura Shtetërore, për shkak të: shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale. Me propozim që të aprovohet ankesa si e bazuar në ligj dhe të priset aktgjykimi A.Nr.2054/19 i datës 31.07.2023 si i pa bazuar.

Pala paditëse nuk ka paraqitur përgjigje në ankesë.

Gjykata e Apelit, shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore në ankesë, dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 49 par.1 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA), lidhur me nenin 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, gjeti se:

Ankesa është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se e paditura Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale – Departamenti për Familjet e Dëshmorëve, Invalidëve të Luftës dhe Viktimave Civile me vendimin e dt. 15.07.2019 e ka refuzuar si të pa bazuar ankesën e N.Sh, Komuna e Drenasit, me të cilën ka kërkuar ti njihet e drejta për pension të skemës invalid i luftës.

Paditësi i pa kënaqur me vendimin e lartcekur të të paditurës Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale - Departamenti për Familjet e Dëshmorëve, Invalidëve të Luftës dhe Viktimave Civile ka ushtruar padi për konflikt administrativ me pretendim se i njëjti është i pa drejtë dhe i pa ligjshëm.

Gjykata e shkallës së parë pas shqyrtimit të padisë së paditësit të paraqitur kundër vendimit të lartcekur të të paditurës Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale – Departamenti për Familjet e Dëshmorëve, Invalidëve të Luftës dhe Viktimave Civile, dhe pas administrimit të provave si në procesverbal të shqyrtimit kryesor, e duke u bazuar edhe në provat dhe dëshmitë e tjera të lëndës bie aktgjykimin e ankimuar me të cilin kërkesëpadinë e paditësit e ka aprovuar në tërësi si të bazuar, duke vendosur sikurse në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar. Me arsyetim

se nga provat e administruara në këtë konflikt administrativ, gjykata e shkallës së parë nga deklaratimet në padi, shkresat e lëndës, si dhe aktvendimi kontestues ka nxjerr konstatimin se e paditura me vendimin dt.15.07.2019 i ka refuzuar paditësit kërkesën për njohjen e të drejtës në pension të skemave se Invalidit të luftës me arsyetimin se pas ekzaminimit direkt të paditësit nga komisioni mjekësor, të njëjtit i kanë caktuar shkallën e invaliditetit prej 10%, gjë që nuk mjafton për sistemim në pagesë. Po ashtu edhe ankesën e paditësit komisioni mjekësor i shkallës së dytë ka vërtetuar konstatimin e komisionit të shkallës së parë dhe i ka dhënë të drejtë kur i ka caktuar shkallën prej 10% të invaliditetit, e cila përqindje nuk korrespondon me sistemim pagese sipas legjislacionit në fuqi, përkatësisht paditësi nuk i plotëson kushte ligjore të nenit 5 paragrafi 1.2.1 si dhe nenit 9 dhe 10 të Ligjit nr. 04/L-054 për Statusin dhe të Drejtat e Dëshmorëve, Invalidëve, Veteranëve, Pjesëtareve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Viktimave Civile dhe Familjeve. Paditësi i pakënaqur me këtë vendim, ka parashtruar padi në këtë gjykatë, duke kundërshtuar ligjshmërinë e të njëjtit. Për të vërtetuar konstatimet e cekura si në arsyetimin e vendimit kontestues lidhur me mosnjohjen e të drejtës së pensionit invalid të luftës, si dhe pretendimet të tjera nga paditësi, për gjendjen shëndetësore të paditësit sipas propozimit të paditësit, gjykata e shkallës së parë ka vendosur që të nxjerr provën përmes ekspertizës mjekësore. Grupi i eksperteve pas ekzaminimit mjekësor të paditësit në ekspertizën mjekësorë të përpiluar me dt. 11.01.2023 konstatohet se paditësi N.Sh në aspektin e përgjithshëm mjekësorë atë ortopedik, neurologjik dhe psikiatrik posedon invaliditet të përgjithshëm jetësorë në shkallë prej 20%. Gjithashtu gjykata e shkallës së parë me propozimin e paditësit për nxjerrjen e provës përmes ekspertizës financiare në seancën e dt. 26.04.2023 ka vendosur që këto konstatime t'i administroj përmes ekspertizës financiare. Nga vlerësimet e nxjerra të Ekspertit Financiar Arian Ibrahimit të dhënë në ekspertizën e datës 26.04.2023 është konstatuar se si dhe në seancën e shqyrtimit kryesor eksperti financiar deklaron se në përputhje me aktvendimin e gjykatës së shkallës së parë që të bëjë përlllogaritjen e kësaj skeme pensionale të Invalidit të Luftës së UÇK-së në shkallë të invaliditetit prej 20%, prej ditës së ushtrimit të kërkesës së dt. 05.12.2018 deri me dt 26.04.2023, duhet të realizon diferencë të pensionit të invalidit të luftës. Kjo është e përcaktuar në skemën e ligjit 04/L-054, kështu që në bazë të kalkulimeve të bëra për vitin 2018; 2019 ; 2020; 2021 dhe viti 2022. Gjukata e shkallës së parë ka vlerësuar se organi i paditur, nuk ka bërë fare arsyetim në vendimin e saj, andaj gjykata e shkallës së parë ka shqyrtuar edhe bazën ligjore në të cilën është arsyetuar vendimi kontestues i të paditurës, përkatësisht duke i 'u referuar dispozitës ligjore, nga neni 10 (par.1) i Ligjit nr. 04/L-054, për Statusin dhe të Drejtat e Dëshmorëve, Invalidëve, Veteranëve, Pjesëtareve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Viktimave Civile dhe Familjeve të tyre parashihet: *“Me qëllim të realizimit të të drejtave dhe beneficioneve, në përputhje me shkallën e invaliditetit dhe përqindjen e përcaktuar të dëmtimit trupor, invalidët e UÇK-së ndahen në tetë (8) grupe: 1.1. Grupi I - invalidët me 81% deri 100% të dëmtimit trupor; 1.2. Grupi II - invalidët me 71% deri 80% të dëmtimit trupor; 1.3. Grupi III - invalidët me 61% deri 70% të dëmtimit trupor; 1.4. Grupi IV - invalidët me 51% deri 60% të dëmtimit trupor; 1.5. Grupi V - invalidët me 41% deri 50% të dëmtimit trupor; 1.6. Grupi VI - invalidët me 31% deri 40% të dëmtimit trupor; 1.7. Grupi VII - invalidët me 20 % deri 30 % të dëmtimit trupor; 1.8. Grupi VIII - invalidët me 10% deri 19% të dëmtimit trupor.* Gjukata e shkallës së parë nuk mund të pajtohet me qëndrimin juridik të dhënë nga e paditura se nuk janë plotësuar kushtet për përfitimin e pensionit për personat invalid të luftës së UÇK-së, në kuptim të nenit 10 (par.1) i Ligjit nr. 04/L-054, për Statusin dhe të Drejtat e Dëshmorëve, Invalidëve, Veteranëve,

Pjesëtareve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Viktimave Civile dhe Familjeve të tyre, për arsye se nga Ekspertiza Mjekësore e datës 11.01.2023, bazuar në ekzaminimin e drejtpërdrejtë të paditësit dhe shkresave të lëndës, grupi i ekspertëve i përbërë nga Dr. V.B - Ortoped , Dr. H.G dhe Dr. V.T -Psikiatër pas ekzaminimit fizik të drejtpërdrejtë është konstatuar se pacienti – paditësi posedon invaliditet të përgjithshme jetësore në shkallën prej 20%, dhe i njëjti ka zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm. Po ashtu gjykata e shkallës së parë i'u referua edhe dispozitës ligjore, nenit 5 (par. 1.2.1) të Ligjit nr. 04/L-054, për Statusin dhe të Drejtat e Dëshmorëve, Invalidëve, Veteranëve, Pjesëtareve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Viktimave Civile dhe Familjeve të tyre, ku parasheh: *“Pensionin invalidor personal e realizojnë: 1.2.1. invalidi i UÇK-së; dhe 1.2.2. invalidi civil i luftës, në përputhje me kushtet dhe kriteret e përcaktuara në këtë ligj.* Se paditësi është veteran –Invalid i luftës së UÇK-së dhe i pajisur me Certifikata Veteran – Invalid i luftës se Ushtrisë Çlirimtare te Kosovës nr.2428 dt.12.01.2016. Baza juridike e aprovimit të kërkesëpadisë që e paditura është përgjegjëse që paditësit t’ia kompensoj shumën në emër të pensionit për persona invalid të luftës, gjënë zbatim në dispozitën ligjore nga neni 46 paragrafi 5 të Ligjit për Konfliktin Administrativ.

Qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë si të rregullt dhe të bazuar në ligj në tërësi e pranon edhe kjo gjykatë, për arsye se aktgjykimi i ankimuar nuk është përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative, të cilat shkelje gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare, në bazë të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative. Gjykata e shkallës së parë, duke vlerësuar ligjshmërinë e vendimeve të kontestuara në kuptim të nenit 44 të Ligjit për Konfliktet Administrative, në drejtim të pretendimeve në padi, provave të administruara në seancë gjyqësore si dhe pas shqyrtimit të shkresave të tjera të lëndës, me të drejtë ka konstatuar se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar.

Sa i përket pretendimeve ankimore të përfaqësuesit të autorizuar të paditurës, se gjykata e shkallës së parë ka bërë shkelje esenciale të dispozitave procedurale, këto pretendime ankimore nuk qëndrojnë, ngase aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë nuk është i përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, e as me shkelje të tjera të cilat do të ndiknin në ligjshmërinë e aktgjykimit të ankimuar. Meqë gjykata e shkallës së parë ka shqyrtuar padinë, fillimisht e ka dërguar padinë përfaqësuesit të paditurës në përgjigje në padi, pastaj ka caktuar seancat dhe seancën e shqyrtimit kryesor, ka nxjerr prova të mjaftueshme, që do të thotë se gjatë vlerësimit gjykata e shkallës së parë nuk ka bërë shkelje të dispozitave të LKA-së dhe LPK-së.

Ndërsa sa i përket pretendimeve ankimore për vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, gjykata e shkallës së parë nuk u bazua nga faktet e dhëna nga e paditura. Në aktgjykim është theksuar se ekspertiza është bërë nga një komision i caktuar nga gjykata, i njëjti komision nuk ka kërkuar se me cilat prova ka kundërshtuar vlerësimin e mjekëve të shkallës së parë kur është bërë ekzaminimi i palës direkt nga komisioni i përbërë nga mjekët përkatës nga këto lëmi: Ortoped, psikiatri dhe kirurgji. Këto pretendime ankimore kolegji i kësaj gjykate nuk i aprovoi, për faktin se vlerëson se janë të pa bazuara, dhe të pa argumentuara me prova konkrete. Sepse gjykata e shkallës së parë me rastin e shqyrtimit të padisë së paditësit, ka nxjerrë prova të

mjaftueshme të cilat vërtetojnë se këto pretendime janë në kundërshtim me gjendjen faktike të vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë. Në këtë kontest në arsyetimin e aktgjykimit, janë dhënë arsye të duhura dhe të mjaftueshme për mënyrën e vërtetimit të fakteve, për provat e administruara dhe për vlerësimin e tyre sa i përket besueshmërisë dhe fuqisë provuese të tyre.

Kurse sa i përket pretendimeve ankimore se gjykata e shkallës së parë për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, gabimisht ka zbatuar edhe të drejtën materiale, ky kolegji po ashtu nuk i aprovoi, kjo për faktin se të njëjtat janë të paqëndrueshme dhe si të tilla janë pa ndikim në vërtetimin e gjendjes tjetër faktike nga ajo e vërtetuar edhe nga gjykata e shkallës së parë. Sepse, sipas vlerësimit të kolegjit të kësaj gjykate, aktgjykimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë është i qartë dhe i kuptueshëm, si dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare të cilat i pranon edhe kjo gjykatë.

Duke marrë parasysh se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale me rastin e aprovimit të kërkesëpadisë së paditësit si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar, e pasi që me pretendimet tjera ankimore një aktgjykim i tillë nuk mund të vihet në pyetje, ankesa e të paditurës u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 49 të LKA-së, lidhur me nenin 200 të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
AA.nr.687/2023, me datë 06.03.2024

Kryetari i kolegjit,
Ramiz Kuqi